



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA E SUHAREKËS**  
**MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA**



---

07Nr.12 datë 20.01.2020  
*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim*  
*The Directorate for Urbanism and Planning*

## RAPORT PUNE PËR VITIN 2019

Janar 2020

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË  
Raport Pune për Vitin 2019

Janar 2020,  
RAPORT PUNE PËR VITIN 2019

PËRMBAJTJE

<b>1. Përshkrim i shkurtër i Aktiviteteve gjatë vitit 2019</b> .....	3
<b>2. Përshkrim i zgjeruar i Aktiviteteve gjatë vitit 2019</b> .....	7
2.1. <i>Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal</i> .....	7
2.2. <i>Hartimi i Hartave Zonale të Komunës</i> .....	9
2.3. <i>Hartimi i Projektit zbatues “Sheshit të Qytetit”</i> .....	10
2.4. <i>Realizimi i Projekteve të ndryshme të tjera</i> .....	13
2.4.1. <i>Trajtimi i hapësirave me interes publik</i> .....	13
2.4.2. <i>Trajtimi i deponive Ilegale</i> .....	14
2.4.3. <i>Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal</i> .....	15
2.4.4. <i>Renovimi i pullazeve të objekteve kolektive të banimit</i> .....	16
2.5. <i>Vendimi nga Kuvendi Komunal për ndryshimin e taksës për Leje ndërtimi</i> .....	15
2.6. <i>Hartimi i Planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në Prona Publike</i> .....	16
2.7. <i>Sistemi i unifikuar i adresave</i> .....	18
2.8. <i>Hartimi i Planit për Menaxhimin e Parkingjeve</i> .....	19
2.9. <i>Trajtimi/legalizimi i objekteve pa leje ndërtimi</i> .....	20
<b>3. Punë të përgjithshme në bashkëpunim me drejtoritë Komunale dhe institucione të tjera</b> .....	22
<b>4. Përmbyllje</b> .....	24

## **1. Përshkrim i shkurtër i Aktiviteteve gjatë vitit 2019**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim gjatë vitit 2019 ka vazhduar me angazhime të larta në punë të ndryshme të cilat i përkasin. Me fillim të vitit një rëndësi e madhe i është kushtuar shqyrtimit dhe mbylljes të lëndëve të trashëguara nga viti paraprak.

Viti 2019 është karakterizuar me pjesën e fundit të procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2019-2027, i cili si projekt kapital i menaxhuar nga drejtoria me procedurë administrative është bartur nga viti paraprak për shkak të specifikave që ka. Sa i përket planeve rregulluese të hollesishme ato ende kanë mbetur të bllokuar si rezultat i kundërshtimeve nga MMPH për çështje procedurale. Risi tjetër që vlen të ceket si e arritur e vitit 2019 është fillimi i procesit (nga shtatori) për hartimin e Hartave Zonale të Komunës. Gjithashtu pas përfundimit të shqyrtimit publik për ndryshimin e taksës për Leje Ndërtimit, Kuvendi Komunal ka aprovuar propozimin përmes vendimit 01Nr.... datë:

Vlen të përmendet hartimi dhe miratimi i Planit për Vendosijen e Objekteve të përkohshme në pronë publike, hartimi i detyrës projektuese dhe procesi i prokurimit për urën/mbikalimin në Shirokë, renovimi i pullazeve të objekteve kolektive, krijimi i hapësirave të gjelbëruara me interes publik, shenjzimi vertikal dhe horizontal i rrugëve, trajtimi i deponive ilegale, etj.

Përkundër vitit 2018, në 2019 Drejtoria është marrë edhe me shqyrtimin e kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje.

Përpos punëve të lartcekura, stafi përgjegjës në drejtori është marrë edhe me kryerjen e shumë punëve dhe angazhimeve varësisht nga lloji i kërkesave të palëve drejtuar DUP dhe Komunës. Gjatë periudhës njëvjeçare janë pranuar **502 lëndë**, ndërsa janë përcjellë **876 shkresa** rreth lëndëve të pranuar si dhe të karakterit të ndryshëm. Gjatë këtij viti janë mbajtur takime të shumta me qytetarë, organizata të ndryshme takime me institucione qendrore si dhe takime të ndryshme në nivel komunal.

**Drejtoria gjatë vitit 2019 është marrë me:**

***Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetareve :***

Gjatë këtij viti kemi pranuar rreth 502 kërkesa të ndryshme të cilat i kemi shqyrtuar me kujdes dhe profesionalizëm. Te kërkesat për kushte ndërtimore është vërejtur një rritje në krahasim me vitet tjera sa i përket ndërtimeve të kategorisë II të cilat kanë kërkuar një përkushtim dhe një analizë më të madhe të stafit profesional gjatë trajtimit të tyre. Kryesisht kemi pranuar kërkesa për :

- a) Kushte Ndërtimore
- b) Leje Ndërtimore
- c) Leje rrënimi
- d) Legalizim të objekteve
- e) Kërkesa për Shfrytëzim të Hapësirave Publike
- f) Kërkesa për vendosje të Sinjalizimeve rrugore
- g) Për Parcelizim
- h) Për Pëlqime në parim dhe përshkrim të planeve
- i) Për Formim të Komisioneve për pranime teknike
- j) Për emërtime të rrugëve
- k) Dhe kërkesa të karakterit të ndryshëm.

***Kemi përcjell shkresa te ndryshme :***

- a) Aktvendim mbi Kushte Ndërtimore
- b) Aktvendim mbi Leje Ndërtimore
- c) Njoftime rreth Kushteve ndërtimore,
- d) Aktvendim mbi Leje rrënimi
- e) Certifikatë Legalizimi
- f) Leje Legalizimi
- g) Vendim për përfshirje në listë të pritjes – për legalizim
- h) Pëlqime për Shfrytëzim të Hapësirave Publike për ekspozim malli, vendosja e objekteve të përkohshme, vazhdim afati për objekte të përkohshme etj.
- i) Pëlqime për parcelizime
- j) Pëlqime në Parim
- k) Konkluzione të ndryshme
- l) Referenca

*DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË*  
*Raport Pune për Vitin 2019*

- m) Përgjigjeje në shkresa të palëve varësisht nga karakteri i tyre si dhe Përcjellja e ankesave të palëve për ministritë përkatëse.
- n) Ftesa , kërkesa, refuzime, njoftime rreth pagesave dhe njoftime të ndryshme.
- o) Janë formuar komisione të shumta për pranim teknik të punimeve dhe për nevoja tjera të drejtorisë dhe komunës. Pranimet teknike janë bërë për investimet kapitale në nivel komunal të cilat kanë qenë nën menaxhimin e drejtorive tjera të komunës.
- p) Janë shqyrtuar ankesat e qytetareve dhe iu kemi kthyer përgjigjeje.

***Punë tjera në drejtori gjatë vitit 2019:***

- a) Përcjellja e proceseve të hartimit të PZHK.
- b) Përcjellja e procesit të hartimit të HZK.
- c) Përcjellja e procesit të zbatimit të Planeve Zhvillimore, Rregulluese dhe atyre të Hollësishëm në nivel Komunal.
- d) Menaxhimi i projekteve kapitale që kanë qenë nën kompetencën e drejtorisë.
- e) Leje të ndryshme për objekte si: ndryshim destinimi, renovime, aneksime, mbindërtime, etj.
- f) Raporte të ndryshme për kryetarin, drejtorinë e financave, ministrinë, asamblenë komunale, drejtorinë dhe auditorët.
- g) Dalje në teren për lëndë të caktuara dhe verifikimi i kërkesave të ndryshme varësisht nga karakteri i tyre.
- h) Vlerësime të ndryshme urbane dhe ndërtimore me kërkesë të palëve apo për nevoja të komunës.
- i) Koordinimi i grupit punues për legalizimin e objekteve pa leje
- j) Hartimi dhe miratimi i planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në Prona Publike.

**Në tabelë prezantohen lëndët për 10 vjet**

	<b>Viti</b>	<b>Protokoli i pranimit</b>	<b>Protokoli i dërgimit</b>	<b>Protokoli për legalizim - pranimi</b>	<b>Protokoli për legalizim - dërgimi</b>
1.	2010	<b>478</b>	<b>762</b>	/	/
2.	2011	<b>572</b>	<b>1063</b>	/	/
3.	2012	<b>594</b>	<b>1083</b>	/	/
4.	2013	<b>580</b>	<b>969</b>	/	/
5.	2014	<b>662</b>	<b>1039</b>	/	/
6.	2015	<b>687</b>	<b>1105</b>	/	/

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË**  
*Raport Pune për Vitin 2019*

7.	2016	<b>713</b>	<b>1132</b>	/	/
8.	2017	<b>826</b>	<b>1239</b>	/	/
9.	2018	<b>525</b>	<b>998</b>	/	/
10.	2019	<b>448</b>	<b>807</b>	<b>54</b>	<b>69</b>

*Tabela 1. Lëndët hyrëse dhe dalëse për 10 vite në DUP*

***Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje rrënimi:***

Sektori i urbanizmit është marrë kryesisht me shqyrtimin e kërkesave të tilla. Kërkesat janë shqyrtuar nga stafi profesional i drejtorisë dhe vendimet janë marrë duke u bazuar në dokumentet e planifikimit, ligjet në fuqi dhe normat teknike të planifikimit hapësinor.

Këtë vit kemi shqyrtuar 42 kërkesa për kushte ndërtimore ku kemi aprovuar 26 prej tyre, të tjerat janë refuzuar apo janë në proces.

Vetëm për objekte ndërtimore (pa e përfshire infrastrukturën) kemi shqyrtuar 32 kërkesa për leje ndërtimore ku kemi aprovuar 25 prej tyre, të tjerat janë refuzuar apo janë në proces.

Kemi shqyrtuar 9 kërkesa për leje rrënimi ku kemi aprovuar 6 prej tyre kurse të tjerat janë refuzuar apo janë në proces.

Për të pasur një zhvillim më të madh sa i përket ndërtimeve në Komunë e që paraprakisht do të duhet të jenë të pajisur me dokumentacion përkatës, Ne si drejtori në vazhdimësi kemi kërkuar metoda dhe mundësi për përkrahje të këtij sektori, si:

- Kemi kërkuar nga Drejtoria e Inspektionit që të jetë më aktiv në teren sa i përket ndalimit të ndërtimit të objekteve pa leje ndërtimore.
- Kemi ndryshuar/ulur taksat për leje të ndërtimit në bazë të kategorisë së objekteve si dhe kemi propozuar të ketë taksë për leje rrënimi.
- Kemi formuar Grupin Punues për Legalizim.
- Jemi angazhuar maksimalisht në koordinimin dhe funksionimin e grupit punues për Legalizimin e objekteve pa leje.
- Kemi publikuar në webfaqen e Komunës si dhe në hollin e objektit komunal udhëzuesin ‘si të pajisemi me leje ndërtimi’ i cili është i përgatitur enkas për qytetarët për t’i informuar më thjeshtë me procedurat të cilat duhet ndjekur (që nga viti 2018).
- Në vazhdimësi në dokumentet planifikuese kemi evituar pengesat e hasura për lëshimin e Kushteve ndërtimore për kërkesa të ndryshme, e që në planifikimet e reja do të eliminohen këto pengesa.
- Në vazhdimësi kemi paraqitur kërkesat tona për rritje të stafit të zyrtarëve kompetente në mënyrë që të funksionalizohet sektori i planifikimit i cili momentalisht nuk ka asnjë zyrtarë.

## **2. Përshkrim i zgjëruar rreth aktiviteteve kryesore të zhvilluara në drejtori gjatë viti 2019**

*Për drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim, prioritet ka qenë :*


- Hartimi i Propozim-Planit Zhvillimor Komunal
- Fillimi i procedurave për hartimin e Draft-Hartave Zonale të Komunës
- Shqyrtimi dhe përmbushja e kërkesave të pranuar në kohë dhe me profesionalizëm
- Hartimi i detyrave projektuese, inicimi i procedurave, Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projekteve kapitale deri në përfundim të tyre.
- Renovimi i pullazeve të banesat kolektive të cilat kanë qenë shumë të dëmtuara.
- Sinjalizimi i rrugëve, me prioritet rrethrotullimet dhe pranë shkollave.
- Trajtimi i Hapësirave Publike me Interes për qytetarët e komunës tonë.
- Pastrimi dhe trajtimi i deponive Ilegale.
- Hartimi i projektit kryesor “Sheshi i Qytetit”.
- Vendim nga asambleja komunale për ndryshimin e taksës për Leje ndërtimi dhe Leje rrënimi.
- Hartimi dhe miratimi i planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në Prona Publike.
- Formimi i grupit punues për Legalizim dhe shqyrtimi me prioritet i kërkesave për legalizimin e objekteve pa leje.
- Përmbyllja e Projekteve Kapitale.

### **2.1. Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal :**

Gjatë këtij viti ka vazhduar hartimi i PZhK-së – dokumenti më i rëndësishëm i Komunës, ku si bartës të tërë procesit ka qenë Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim. Në koordinim me Ekipin Komunal për Planifikim, Grupet punuese të drejtorive, Këshillin e Ekspertëve të Planifikimit, Kompaninë Konsulente “Insi” nga Prishtina dhe gjithë kontribuesit të tjerë, kemi arrit që Propozim Planin ta përcjellim për MMPH për marrjen e pëlqimit e cila mundëson hapjen e shqyrtimit publik me qytetarë.

Gjatë këtij viti janë mbajtur disa takime me Ekipin Komunal të Planifikimit. Në këto takime është punuar në grupe rreth kornizës së zhvillimit hapësinor të dokumentit për tetë (8) vitet e ardhshme të Komunës së Suharekës.

*DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË*  
*Raport Pune për Vitin 2019*



*Harta 1 Harta e zhvillimit hapësinor të planifikuar*

*Harta 2 Harta e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës*

Në qershor të këtij viti, Komuna ka organizuar punëtorinë një ditore me qëllim të finalizimit të Dokumentit, para aplikimit në Ministri (MMPH) për marrjen e pëlqimit për shqyrtim publik. Në këtë punëtori janë diskutuar tri (3) faza të draftdokumentit.

1. Kornizën e Zhvillimit Hapësinor,
2. Prioritetet Strategjike, dhe
3. Planin e Veprimit.
- 4.

Në këtë takim morën pjesë:

1. Përfaqësues të Ministrive të Qeverisë së Kosovës
2. Këshilli i ekspertëve të Planifikimit hapësinor në nivel Komunal
3. Përfaqësuesit e vendbanimeve
4. Drejtorët e Drejtorive Komunale
5. Grupi Komunal për Planifikim
6. Përfaqësues të ndërmarrjeve Publike
7. Përfaqësues të Partive Politike
8. Kompania Konsulente “Insi”
9. Përfaqësues të qendrës së Biznesëve
10. LMT



*Foto 1. Punëtorja për Planin Zhvillimor Komunal*

Nga pikat e diskutuara në këtë punëtori kanë dalur shumë rekomandime të cilat kanë ndihmuar në finalizimin e dokumentit në fjalë.



Pas punëtorisë, EKP-ja ka përgaditur dokumentacionin për ta përcjell dokumentin në MMPH për marrjen e pëlqimit për hapjen e shqyrtimit publik me qytetarë. Pas kontrollimit të dokumentacionit, MMPH-ja ka përcjellur rekomandime për Komunën të cilat është kërkuar të përfshihen brenda propozim planit. Komuna pas pranimit të rekomandimeve ka filluar shqyrtimin e tyre, përpunimin dhe plotësimin e draftdokumentit dhe planifikon që më së largu në Shkurt të vitit 2020 të rikërkoj marrjen e pëlqimit.

Pas marrjes së pëlqimit, dokumenti do të jetë i ekspozuar 30 ditë kalendarike në hollin e Komunës, ku dhe do të pranojmë komente dhe sugjerime nga qytetarët. Ky dokument hap rrugë që planet tjera në vazhdim të përpunohen dhe kompletohen në suaza të kornizave të tij duke u detalizuar dhe plotësuar me të dhëna detale të cilat ndihmojnë proceset e zhvillimit të komunës në përgjithësi në të ardhmen.

## **2.2. Hartimi i Hartave Zonale të Komunës**

Në Shtator të këtij viti, pas nënshkrimit të Kontratës me operatorin ekonomik “INSI” me seli në Prishtinë, Komuna ka filluar hartimin e Hartave Zonale të Komunës. DUP si bartëse e këtij procesi ka mbajtur disa takime me kompaninë, ku fillimisht është definuar plani dinamik për hartimin e këtyre hartave.

Nga ana e Kryetarit të Komunës është formuar Ekipi Komunal për Planifikim (EKP) me përbërje të të gjitha sektorëve komunale. Para EKP, nga Kompania “INSI” është mbajtur një prezantim përmbajtësor se çka janë hartat zonale dhe në cilat faza kalon hartimi i tyre.



*Foto 1 Diskutimi publik I-rë për harta zonale*

Gjithashtu, me datë 27.11.2019 është mbajtur diskutimi i parë me qytetarë, ku para të pranishmëve u prezantua se cka trajtojnë dhe çka definojnë hartat zonale. Meqenëse ky takim i parë ishte më i përgjithshëm dhe informativ, nga të pranishmit u kërkuar të jenë sa më aktiv në këtë proces duke marrë pjesë aktive në takime me vërejtje dhe komente të vazhdueshme. Njëherit nga ta është kërkuar që për çdo pakjartësi në draftet e propozuara rreth lagjeve të tyre dhe kërkesave që dalin nga gjendja aktuale në teren tu drejtohen me shkrim zyrave të urbanizmit ose me paraqitje fizike në mënyrë që dokumenti maksimalisht t'i përfshijë interesat e tyre në kuadër të kornizave të tij.

### **2.3. Hartimi i Projektit zbatues të Sheshit të Qytetit**

Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim në Komunën e Suharekës duke u bazuar në prioritetet e caktuara nga plani zhvillimor dhe rregullues (qysh nga 2008) e ka parë të arsyeshme fillimin e procedurave për hartimin e projektit për “Sheshin e qytetit” sipas standardeve evropiane. Për këtë zonë të qytetit e cila prek segmentin kryesor nga ura e vogël, rruga “Abdyl Rama” deri te rruga ish “Mulla Nura”, Bodrumi i verës, gjatë këtij viti është hartuar projekti kryesor zbatues (sipas detyrës projektuese dhe kërkesave të dalura nga zyra e prokurimit dhe takimet e mbajtura në nivel komunal për këtë çështje) pas shpalljes së fituesit nga komisioni i pavarur profesional i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.

Pas shpalljes së fituesit dhe nënshkrimit të kontratës për hartimin e projektit zbatues, menaxhimin dhe koordinimin e projektit zbatues e ka bërë Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim, ku

- a) Fillimisht ka organizuar debat publik me qytetarë, ku nga kompania fituese është prezantuar projekt ideja. Nga qytetarët kemi pranuar komente dhe sugjerime të cilat sipas arsyeshmërisë i kemi përfshirë në projektin kryesor.



*Foto 3. Diskutimi publik me qytetarë për projekt idenë e Sheshit të Qytetit*

- b) Kemi ekspozuar pano/dukje të projekt propozimit në hollin e komunës në mënyrë që të gjithë qytetarët të informohen rreth këtij projekti e gjithashtu të mund të japin komente dhe sugjerime para përfundimit të projektit zbatues. Propozim projektin e kemi ekspozuar edhe në muret e sallës së Asamblesë Komunale ku delegatët kanë pasur mundësi ta analizojnë, diskutojnë dhe të komentojnë sipas nevojës.



*Foto 4. Ekspozimi i projekt idesë së Sheshit në Hollin e Komunës*

*DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË*  
*Raport Pune për Vitin 2019*

- c) Kemi mbajtur takime të shumta me OE, drejtoritë/sektoret, zyren e kryetarit të komunës ku pikat kryesore të diskutimit kanë qenë funksionaliteti, forma e shfrytëzimit në të ardhmen, rrugët alternative, vendparkingjet, si dhe kosto ekonomisht e përballeshme.



*Foto 5. Takimet/diskutime rreth projektit zbatues të Sheshit të Qytetit*

- d) Bazuar në kërkesën e DUP-së, kryetari i Komunës ka formuar komision të jashtëm profesional për pranimin e projektit kryesor.
- e) Kemi ekspozuar pano/dukje të projektit me përshkrim pëmbajtësor në qytet-tek ura e madhe në mënyrë që të gjithë qytetarët të informohen rreth këtij projekti.
- f) Pas përfundimit të të gjitha procedurave të pranimit, Projekti zbatues është dorzuar pranë Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë (DShPME), e cila menaxhon me fondet për realizimin e këtij projekti.
- g) Kemi mbajtur konferencë për media para fillimit të ndërtimit të Sheshit, ku nga ana e DUP-së është prezantuar procesi deri në hartim të projektit kryesor.



*Foto 6. Konferenca për media para fillimit të ndërtimit të Sheshit*

- h) DShPME ka aplikuar për Leje Ndërtimi për projektin në fjalë, i cili në Tetor është Pajis me Leje ndërtimi dhe ka filluar me fazën e Implementimit.
- i) Vlen të ceket se edhe gjatë fazës së zbatimit, projekti në vazhdimësi po vazhdon të mbikqyret nga stafi i drejtorisë në të gjitha fazat, ku në bazë të vizitave dhe raporteve të lëshuara është konstatuar se procesi i realizimit të projektit po ecen mirë me një cilësi dhe kualitet të lartë të punimeve si dhe me një dinamikë të përshpejtuar të punëve.

#### **2.4. Realizimi i Projekteve të ndryshme të tjera:**

Përmes Procedurave të Prokurimit janë kontraktuar Operatorët Ekonomik për realizim të projekteve të ndryshme kapitale për Komunën e Suharekës të cilat i menaxhon DUP, si projekte për sinjalizim, deponitë ilegale, trajtim të hapësirave publike dhe renovim të pullazëve të objekteve kolektive.

##### **2.4.1. Trajtimi i hapësirave publike**

Përmes këtij projekti kapital, drejtorja jonë ka analizuar me kujdes nevojat më të mëdha për trajtim të hapësirave të përbashkëta publike, ku përmes këtij projekti janë realizuar këto punime :

- o Rregullimin e hapësirave publike në Shirokë përgjatë rrugës “Brigada 123”. Ku përmes këtij projekti është bërë gjermimi dhe rrafshimi i dheut, mbjellja e barit dhe mbjellja e pemëve të ndryshme, etj.
- o Rrethimi i trotuarëve përgjatë rrugës “Brigada 123” në Shirokë pranë rrethrotullimit për siguri të këmbësorëve e veqanarisht stimulimi i nxënësve për të shqyrtëzuar nënkalinimin e jo kalimi i rrugës vend e pa vend.
- o Rregullimi i hapësirës te Tregu Javor, ku janë trajtuar disa shirite gjelbruese dhe janë mbjellur pemë dekorative.
- o Mbjellja e drunjëve dekorativ përgjatë rrugës “Skenderbeu” dhe në Reqan.
- o Janë trajtuar rrethrotullimet në zonë urbane me trajtim dhe rrafshim të dheut dhe mbjellje të barit.



*Foto 7. Gjatë trajtimit të hapësirave publike në Shirokë*



*Foto 8. Gjatë aksionit të mbjelljes së drunjëve në Reqan*

- Mbjellja e luleve dekorative në zonë Urbane dhe në disa Shkolla.
- Ndërtimi i parkut pranë Sheshit “Besim Ndreca”. Ku përmes këtij projekti është bërë germimi dhe rrafshimi dhe trajtimi i dheut, ndërtimi i shtigjeve të ecjes, mbjellja e pemëve të ndryshme, rregullimi i këndit të lojërave të fëmijëve, vendosja e mobiluarit urban (ulëse, shporta etj.), etj.



*Foto 8. Gjatë rrënimt të Garazhave montazh dhe fillimi i ndërtimit të parkut*



*Foto 9. Gjatë ndërtimit të parkut pranë Sheshit “Besim Ndreca”*

#### **2.4.2. Trajtimi i deponive Ilegale :**

Përmes këtij projekti, drejtorja jonë ka analizuar me kujdes nevojat më të mëdha për trajtim të hapësirave të mbuluara nga mbeturinat, ku me anë të këtij projekti kapital janë realizuar këto punime:

- Janë identifikuar deponitë ilegale të mbeturinave, ku janë incizuar shumica e deponive e sidomos ato në prona publike. Ky identifikim është bërë nga një ekip me përbërje të zyrtarëve nga DShPME, Ekoregjioni, Giz dhe përfaqësues të Let's do it Kosova.
- Është bërë pastrimi i disa prej deponive ilegale.
- Kurse pjesa tjetër e deponive, synojmë t'i pastrojmë gjatë vitit tjetër, pas nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik.

**2.4.3. Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal :**

Përmes këtij projekti, drejtorja jone ka analizuar me kujdes nevojat me të mëdha për sinjalizim rrugor, ku me anë të këtij projekti kapital janë realizuar këto punime:

- Punimi i vendkalimeve të këmbësoreve – me prioritet zebat pranë shkollave dhe në përgjithësi në zonë urbane.
- Vendosja e Sinjalizueseve vertikal dhe horizontal.
- Sinjalizimi i vendparkingjeve të punuara te rruga ‘Abdyl Rama”, oborri i Komunës dhe pranë parkut të qytetit.
- Sinjalizimet e rrethrotullimeve me prioritet shenjat orientuese të drejtimeve.
- Sinjalizimi me vijë të bardhë të rrugëve të cilat lidhen direkt me zonën urbane.
- Sinjalizimi i rrugëve të tjera sipas kërkesave të qytetareve dhe nevojave themelore.
- Krijimi i shtigjeve të biçikletave.
- Vendosja e pengesave në rrugë (rreth 15 njesi) me prioritet pranë shkollave por edhe në qendra të fshatrave, si: Studenqan, Samadrexhë, Njëpëbisht, Tërrnje, Savrovë, Bukosh, Mushtisht, Suharekë, Sallagrazhde.

Për të gjithë pengesat horizontale në rrugë të cilat ndikojnë në zvogëlimin e shpejtesisë së automjeteve në komunikacion, të punuara në teren janë vendosur edhe shenja vertikale adekuate që paralajmrojnë pengesë.



*Foto 10. Pengesat horizontale në rrugë*

**2.4.4. Renovimi i Pullazeve të objekteve kolektive të banimit :**

Përmes këtij projekti, drejtoria jonë ka analizuar me kujdes nevojat më të mëdha për renovim të pullazeve, varësisht nga kërkesat e ndryshme të qytetarëve dhe inspektimet që i kemi bërë në teren, ku me anë të këtij projekti kapital janë realizuar këto punime :

- Kemi shqyrtuar kërkesat e qytetareve për nevojat që kanë për renovim të pullazeve të objekteve kolektive.
- Kemi analizuar gjendjen në teren dhe kemi identifikuar cilat objekte janë me prioritet për tu renovuar për këtë vit.
- Janë renovuar pullazet të disa prej objekteve kolektive në zonë urbane, si:
  - Objekti me seksione te Banesat e Ballkanit
  - Banesa e kaltër përgjatë rrugës “Brigada 123”
  - Banesa në pronë komunale pranë urës së madhe.



*Foto 11. Gjatë realizimit të punimeve në pullazet e banesave kolektive*

Vlen të cekët që DUP gjatë kësaj periudhe prioritet ka pasur renovimin e pullazeve, kurse pas përfundimit të tyre do të vazhdojë me renovime të fasadës dhe renovime të tjera sipas nevojave të objekteve publike.

**2.5. Vendimi nga Kuvendi Komunal për ndryshimin e taksës për Leje ndërtimi**

Në fund të vitit 2018, Komuna në perputhje me dispozitat ligjore ka propozuar në MMPH ndryshimin e taksës për leje ndërtimi si dhe ka propozuar taksë për Leje rrënimi. Ky propozim u miratua nga MMPH në fund të vitit 2018 dhe doli në shqyrtim publik për qytetarë deri në fillim të shkurtit të këtij viti. Pas shqyrtimit publik, Kuvendi Komunal përmes vendimit 01Nr.016-21653 datë 29.03.2019 ka miratuar propozimin-ndryshimin e taksës administrative dhe atë të infrastrukturës të formuluar nga DUP.

Ky propozim nga ana e DUP-së ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve, por ndër kryesoret ka qenë të hyrat jo të mjaftueshme gjatë vitit 2018.

Vlen të cekët që një veprim i tillë ka ndikuar në rritje të të hyrave financiare nga lejet e ndërtimit gjatë këtij viti. Në tabelën e mëposhtme mund të gjeni të hyrat e planifikuara dhe të realizuara gjatë 6 viteve të fundit.

Viti/Të hyrat financiare	Të Planifikuara	Të realizuara	Në përqindje
2014	120,000.00 €	43,788.79 €	<b>36.49%</b>
2015	128,000.00 €	128,715.91 €	<b>100.56%</b>
2016	125,000.00 €	95,166.54 €	<b>76.13%</b>
2017	124,000.00 €	192,881.46 €	<b>155.55%</b>
2018	127,000.00 €	72,989.23 €	<b>57.47%</b>
2019	130,272.00 €	139,910.04 €	<b>107.40%</b>

*Tabela 2. Të hyrat financiare të planifikuara dhe të realizuara ndër vite*

**2.6. Hartimi dhe Miratimi i Planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në Prona Publike**

Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim në Suharekë duke u mbështetur në Rregulloren për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohëshme në pronën publike dhe private 01Nr.16-4719 datë 30.06.2016 si dhe në vendimin 01Nr.016-9287 datë 06.02.2019 të Kryetarit të Komunës për formimin e grupit punues ka inicuar procedurën për hartimin e Planit për vendosjen e objekteve të përkohëshme në pronën publike.

Grupi punues i përbërë nga Agron Bajraktari, Sedat Bytyqi dhe Sinan Vrella në bazë të autorizimit dhe kompetencave të dhëna me vendim nga Kryetari i Komunës ka hartuar planin për vendosjen e objekteve të përkohëshme në pronën publike. Punës së grupit iu është bashkangjitur edhe Elona Buqa, arkitekte (në cilësinë e praktikantes). Gjatë këtij procesi janë mbajtur shumë takime pune në kuadër të drejtorisë, janë bërë vizita në teren, incizime dhe mbledhje informatash. Një kontribut të veçantë në përmbajtje të



*DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË*  
*Raport Pune për Vitin 2019*

dokumentit dhe kompletim në faza të caktuara të tij e ka dhënë edhe stafi tjetër profesional i drejtorisë, si dhe zyrtarë/gjeodet nga DShPJK.

Qëllimi i hartimit dhe miratimit të planit është që konform Rregullorës dhe legjislacionit në fuqi të përcaktohen lokacionet e përshtatshme të pronave publike për vendosjen e objekteve të përkohshme. Ky plan krijon mundësi më të lehtë për punë duke ofruar të dhëna në detale dhe duke mundësuar qasje me të lehtë ligjore për mënyrën e veprimeve në rastet e shqyrtimit të kërkesave të palëve (përonave fizik dhe juridik) për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronat publike në lokacionet e dëfinuara sipas skicave, fotove dhe përshkrimeve të ofruara në këtë plan.

Në kuadër të këtij plani llojet e objekteve të përkohshme janë:


- Paisjet reklamuse dhe informuese (*Portalet me pano reklamuese, Pano me ndricim, murale grafike, tabela per njoftime*)
- Objektet e përkohëshme montuese-shfrytezuere (*lokalet e perkohshme dhe kioskat*)
- Paisjet Lëvizëse (*terasat para lokaleve afariste dhe mjetet levizese*)
- Paisjet për lojra të fëmijëve,
- Mbulesat për strehimin e njerzëve në transportin publik,
- Antenat satelitore,
- Gërmimi, Shtrirja e Rrjetit Kabllor
- Paisje të tjera të ngjashme dhe objekte të cilat sipas kushteve të kësaj rregulloreje kanë karakterin e objekteve të përkohshme.

Puna e komisionit këtë vit ka filluar me shqyrtimin gjendjes aktuale të objekteve të përkohëshme që janë të vendosura në lokacione të ndryshme dhe pastaj ka realizuar vizita në teren në të gjithë teritorin e Komunës duke identifikuar hapësira adekuate se ku do të mund të vendosen objektet e përkohëshme, ka marrë informatat e nevojshme nga Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër si dhe ka marrë për bazë të gjitha dokumentet e planifikimit që Komuna ka në dispozicion për hartimin e këtij plani. Plani përmban pjesën tekstuale dhe grafike.



*Foto 12. Foto nga puna në teren gjatë identifikimit të lokacioneve për vendosjen e vendndalesave për pritjen e autobusëve*

Me datë 28.06.2019 DUP ka mbajtur diskutim publik me qytetaret duke prezentuar draft planin e që ka arritur të merr sugjerimet vërejtjet por edhe propozime të reja të cilat i ka përfshirë në dokumentet.




*Foto 13. Takimi publik me qytetarë*

Pas debatit publik DUP këtë dokument e kemi vendosur në shqyrtim publik dhe kemi ftuar qytetarët që të japin kontributin e tyre përmes sugjerimeve dhe komenteve. Nga ana e qytetarëve nuk kemi pranuar komente kurse nga ana e asambleistëve të Kuvendit Komunal, kemi pranuar dy komente nga z.Ardian Shala dhe z.Bashkim Ndrecaj, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i ka marrë për bazë në hartim të planit.

Pas përfundimit të të gjitha procedurave, Kuvendi Komunal ka aprovuar Planin përmes vendimit 01Nr.016-66603 datë 20.09.2019.

### **2.7. Sistemi i unifikuar i adresave**

Duke marrë për bazë vendimin mbi miratimin e ndryshimit të disa emërtimeve të rrugëve nga Kuvendi Komunal 01Nr.016-74585 datë 26.11.2018, DUP gjatë këtij viti është mobilizuar në zbatimin e atij vendimi. Në gjashtë mujorin e parë Komuna ka angazhuar një zyrtar profesional për sistemin ARIS në mënyrë që t'i përfshijë në databazë të gjitha ndryshimet e emërtimeve të rrugëve. Këto ndryshime u realizuan në bashkëpunim të plotë me Agjensionin Kadastral.



*Foto 14. Takim me AKK për sistemin e adresave*



*Foto 15. Takim me AKK për sistemin e adresave*

Gjithashtu, për implementim të ndryshimeve të tabelave në teren, DUP ka mbajtur takime të shumta me Agjensionin Kadastral ku ka kërkuar përkrahje financiare për realizim të këtij projekti. Nga takimet e mbajtura me Kryeshefin z.Ahmeti, jemi njoftuar që AKK nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për përkrahje dhe se donatorët e kaluar nuk janë

duke ofruar më donacione në këtë drejtim. Por që gjatë vitit 2020-2021 AKK ka prioritet implementimin në tërësi të sistemit të adresave, duke i përkrahur maksimalisht Komunat me planifikim buxhetor nga Ministria. Në këtë rast, për AKK Suhareka do të jetë prioritet për implementimin në tërësi të sistemit të adresave (emërtimet e rrugëve dhe numrat e hyrjeve).

### **2.8. Hartimi i Planit për Menaxhimin e Parkingjeve**

Parkingjet ne vend jo te duhur, mos respektimi i kriterëve te caktuara nga DUP gjate ndertimit te objekteve, parking para hyrjeve te objekteve publike, parkimi ne rruge, para hyrjeve te shkollave dhe objekteve te institucioneve tjera publike, parking apo bllokimi i zonave te parkingeve ne prone publike vetem per biznese private para lokaleve jane vetem disa nga problemet me te cilat ballafaqohet komuniteti si dhe zona urbane ne Suhareke. Duke marrë parasysh analizën e gjendjes ekzistuese, dhe nevojat për një menaxhim më të mirë të parkingjeve, Komuna ka filluar hartimin e Planit për Menaxhimin e Parkingjeve.



*Foto 16. Identifikimi i parkingjeve ekzistuese*

**TABELA E PARKINGJEVE**

NR	AUTOCAD	ORTOFOTO	SIPERFAQJA	NR. PARCELES	NR PERAFERT PARKINGJEV	EMRI I RRUGES	PËRSHKRIV I LOKACIONE
4			170.024m <sup>2</sup>	01165-5	10	Brigada 123	Prapa qendrës zëjtare 1
5			260.361m <sup>2</sup>	01165-5	8	Brigada 123	Prapa qendrës zëjtare 1
6			145.37m <sup>2</sup>	01164-0	10	Brigada 123	Prapa qendrës zëjtare 1

*Foto 17. Analiza e lokacioneve, sipërfaqes, nr. të vendparkingjeve,etj.*

Qëllimi ka qenë përmbushja e kërkesave dhe nevojave të qytetarve duke arritur një zgjidhje efikase të problemit për çështjen që ka të bëjë me parkimin në qytet. Dhe ky lloj plani synohet të jetë mënyra më e mirë e zgjidhjes që përmes ofrimit të drejtë dhe të njejtë të vendparkingjeve për të gjithë qytetarët dhe në të njejtën kohë të jetë edhe zgjidhje afatgjate.


DUP si sektor i rëndësishëm i Komunës do t'i përkushtohet zhvillimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që ofron dhe do të synon që vazhdimisht do të mundësojnë qasje për vendet e parkimit për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për këto shërbime. Synimi i DUP-së është të arrij standarde të larta në veprimtarinë e parkimit që është edhe thelbi për themelet e zhvillimit të infrastrukturës për të ardhmën si dhe produktiviteti dhe implementimi i risive projektuese me synime inovative. Plani si i tillë ka filluar të hartohet në vitin 2019 dhe gjatë vitit 2020 synojmë ta përfundojmë dhe miratojmë në Kuvendin Komunal. Arsyeja pse nuk kemi mundur ta përfundojmë hartimin në tërësi të këtij plani brenda vitit 2019 është ngarkesat e mëdha të punës me të cilat ngarkohet numri i vogël i shërbyesëve civil në drejtori.

Vlen të cekët që në fazën e identifikimit dhe analizave të gjendjes ekzistuese të parkingjeve, kanë kontribuar gjeodetët Atdhe Buzhala dhe Kujtim Gash inga DShPJK.

### **2.9. Trajtimi/legalizimi i objekteve pa leje ndërtimi**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për trajtimin e objekteve pa leje, Komuna është mobilizuar në formën më të mirë të mundshme që ky ligj të zbatohet në Suharekë. Me formimin e grupit punues nga Kryetari i Komunës, jemi përkushtuar që gjatë vitit 2019-2020 prioritet të jetë shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për trajtim të objekteve pa leje. Gjatë këtij viti janë ndërmarrë disa hapa rreth legalizimit të objekteve si dhe kemi mbajtur takime dhe prezantime të rëndësishme duke u klasifikuar në këtë formë si Komunë shembull nga niveli qendror dhe organizatat e ndryshme.

- Qysh në fillim, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, kemi publikuar njoftim publik për qytetarë përmes së cilit perveq që i kemi njoftuar që do të fillojë trajtimi i objekteve pa leje,



*Foto 18. Fletushka vetdijësuese*

i kemi njoftuar që njëra ndër pikat kryesore për trajtim të objektit është prona në të cilin është i ndërtuar

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË**  
*Raport Pune për Vitin 2019*

objekti. Andaj, të gjithë ata që nuk e kanë të definuar çështjen pronësore, i kemi sugjeruar të fillojnë me procedurat.

- Kemi formuar organogramin e punës së grupit punues i cili është i ndarë në 5 faza dhe në të gjitha fazat për secilin zyrtar përshkruhen detyrat e punës.
- Jemi përkushtuar në organizimin e fushatave vetdijësuese për informim sa më të mirë të qytetarëve dhe për përfitimet që sjell legalizimi i objektit pa leje.
- Kemi shpërndarë fletushka dhe njoftime rreth informimit më të qartë se si duhet të bëhet aplikimi.
- Kemi mbajtur 10 diskutime publike në zona të ndryshme që e kanë përfshirë gjithë komunën.



Foto 19. Njoftime rreth përfitimeve në legalizim



Foto 20. Gjatë diskutimeve publike me qytetarë

Prezantimet gjatë këtyre takimeve publike kishin me fokus informimin sa më të mirë të qytetarëve rreth procedurave se si legalizohet objekti, çfarë përfitojnë, cilat janë përparësitë etj. Prezantimet u bënë në këto vendbanime por që janë përfshirë edhe fshatrat përreth zonës ku është bërë prezantimi:

Zona Kadastrale	Vendi/ Koha	Data	
Diskutimi i I-ë Bukosh	Savrovë	Shkolla Fillore "Vilëzërit Fmshëri" në Bukosh Ora 13:30	29.10.2019
	Sopijë		
	Vranqi		
	Mushitsh		
Diskutimi i II-ë Sallagrazhdë	Dubrave	Shkolla Fillore "Edin Durhami" në Mushitsh Ora 15:00	29.10.2019
	Mandivë		
	Dellçec		
	Dveran		
Diskutimi i III-ë Budakove	Papaz	Shkolla Fillore "Lidhja e Prizrenit" në Budakovë Ora 13:30	30.10.2019
	Vërshëc		
	Krushicë e Epërme		
	Krushicë e Poshtme		
Diskutimi i IV-ë Duhël	Staravuçinë	Shkolla Fillore "Sadri Duhël" në Duhël Ora 15:00	30.10.2019
	Mohlan		
	Qudrak		
	Greqecë		
Diskutimi i V-ë Kastërë	Luzhnicë	Shkolla Fillore "Hassan Prishtina" në Semetisht Ora 13:30	31.10.2019
	Javor		
	Bllacë		
	Nishor		
Diskutimi i VI-ë Kastërë	Breshanë	Shkolla Fillore "Kongresi i Manastirit" në Studençan Ora 15:00	31.10.2019
	Studençan		
	Neperisht		
	Reshtan		
Diskutimi i VII-ë Peqan	Reçan	Shkolla Fillore "Dëshmorët e Tivarit" në Peqan Ora 13:30	01.11.2019
	Shirokë		
	Gjimoc		
	Gelancë		
Diskutimi i VIII-ë Leshan	Terme	Shkolla Fillore "Migjeni" në Gjimoc Ora 15:00	01.11.2019
	Leshan		
	Shkollë		
	Shkollë		
Diskutimi i IX-ë Suharekë	Reçan	Salla e Asamblesë Komunale Suharekë Ora 13:30	04.11.2019
	Shirokë		
	Shirokë		
	Shirokë		
Diskutimi i X-ë Suharekë	Reçan	Salla e Asamblesë Komunale Suharekë Ora 13:30	05.11.2019
	Shirokë		
	Shirokë		
	Shirokë		

Foto 21. Vendbanimet ku janë mbajtur diskutimet publike dhe përfshierja e zonave përreth

*DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË  
Raport Pune për Vitin 2019*

- Takime të shumta komunale dhe qendrore, ku komuna është marrë shembull praktik i zbatimit të këtij ligji.




*Foto 22. Gjatë punëtorisë së organizuar nga MMPH dhe USAID-I, ku morën pjesë zyrtarë të grupit për legalizim*



*Foto 23. Takimi me nivelin qendror MMPH dhe USAID, ku u shpalos nga DUP puna e deri atëherëshme rreth trajtimit të objekteve pa leje dhe hapat të cilat janë ndërmarrë*

- Punëtorja 3-ditore e organizuar nga OSCE dhe MMPH ku pjesëmarrës ishte dhe zyrtari ligjor nga DUP Sinan Vrella. Kjo punëtori u organizua me qëllim të hartimit të udhëzuesit për zbatim të ligjit dhe udhëzimeve administrative. Në këtë formë Komuna e Suharekës me zyrtarin ligjor nga Drejtoria për Urbanizem dhe Planifikim, ka dhënë kontribut në hartim të këtij udhëzuesi për shërbim të përgjithshëm dhe lehtësim në rrjedhën e procesit të trajtimit të objekteve pa leje.



*Foto 24. Gjatë punëtorisë 3-ditore në Maqedoninë e Veriut*



- Në kolegjiun e drejtorive të urbanizmit, DUP ka prezantuar hapat të cilat i ka ndërmarrë për zbatim të këtij ligji, sfidat në të cilat ka hasur gjatë këtij procesi, si dhe hapat e mëtutjeshëm që planifikon t'i ndërmarrë. Nga ky prezantim Komuna mori lëvdata të shumta nga niveli qendror, si dhe nga Komunat prezente për të cilët ky prezantim shërbeu si udhëzim për tu praktikuar edhe për komunat e tyre.

*DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM-KOMUNA SUHAREKË  
Raport Pune për Vitin 2019*



*Foto 25. Gjatë prezantimit para kolegjiut të Drejtorive të Urbanizimit dhe nivelit qendror*

- Usaid-i zgjodhi Komunën e Suharekës për të parë nga afër Lëshimin e çertifikatës së Legalizimit, taskforcat të cilat i ka ndërmarrë si dhe po atë ditë është lëshuar çertifikata e legalizimit për një nga kërkesat, të cilin objekt e vizituar bashkë me përfaqësuesit e USAID-it.



*Foto 26. Foto nga takimi me përfaqësuesit e Usaid-it dhe vizita tek objekti i legalizuar*

Vlen të cekët që gjatë vitit 2019, DUP ka pranuar 54 kërkesa për legalizim të objekteve, nga këto kërkesa 10 objekte janë legalizuar, 7 kërkesa kanë hyrë në listë të pritjes, 2 objekte janë pajisur me leje legalizimi kurse kërkesat të tjera janë në proces.

### **3. Punë të përgjithëshme në bashkëpunim me drejtoritë Komunale dhe institucione të tjera**

- Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal në bashkëpunim me Ekipin Komunal për Planifikim, Këshillin e Ekspertëve, Ndërmarrjet Publike dhe Private, etj.
- Hartimi i Hartave Zonale të Komunës në bashkëpunim me Ekipin Komunal për Planifikim, Këshillin e Ekspertëve, Ndërmarrjet Publike dhe Private, etj.
- Menaxhim dhe Mbikqyrje të Projekteve Kapitale përpos ato të Drejtorisë, vlen të cekem mbikëqyrja e “Sheshit të Qytetit” dhe “Shtëpisë së Kulturës”, si ndër projektet më të rëndësishme gjatë këtij viti për Komunën e Suharekës.



*Foto 27. Mbikëqyrja e “Shtëpisë së Kulturës”*



*Foto 28. Mbikëqyrja e “Sheshit të qytetit”*

- Koordinim dhe bashkëpunim me të gjitha Drejtoritë për realizim sa më të mirë të Projekteve me rëndësi për Komunën.
- Pjesë e organizimeve të shumta me rëndësi për Komunën.
- Pjesë e organizimit të ditës botërore pa makina me moton “EC ME NE”. Java evropiane e lëvizshmërisë, ku Komuna e Suharekës



*Foto 29. Shënimi i ditës ndërkombëtare pa makina*

është përzgjedhur nga MMPH-ja për t’u shënuar këtë ditë. Kjo ditë u shënuar me shumë aktivitete, si bllokim i rrugës kryesore për makina ku parakaluar qytetarë me bicikleta dhe ecje në këmbë, aktivitete sportive, mbjellje të drunjëve dekorativ, punime të ndryshme nga nxënësit, etj.

- Pjesë e ekipit punues për dekorimi i qytetit për festat e fundvitit, ku këtë vit dekorimi i qytetit u punua falë bashkëpunimit të arritur me shkollën teknike “Skender Luarasi”.






Foto 30. Dekorimi i qytetit në bashkupim me nxënësit e Sh.m.t. "Skender Luarasi"



Foto 31. Gjatë mbjelljes së Drunjëve dekorativ

- o Realizimi i projektit "Mbjellja e drunjëve dekorativ" i cili projekt është menaxhuar dhe mbikëqyrur nga MMPH por është koordinuar nga Komuna. Përmes këtij projekti janë mbjellur rreth 3000 drunjë dekorativ.
- o Pjesë e organizimeve të ndryshme me rëndësi për "Rolin e Gruas" në vendimmarrje dhe në përgjithësi
- o Pjesëmarrje në komisione për hartim të rregulloreve komunale.
- o Pjesëmarrje në shumë komisione tjera vlerësimi, pranime teknike, rreth procedurave të prokurimit publik, rreth kontrollimit të projekteve të ndryshme, testimi dhe vlerësimi i pranimit të shërbyesëve civil,etj.
- o Dorëzim të raporteve të ndryshme varësisht nga kërkesat e Kryetarit, si raporte javore, mujore, 3-mujore, 6- mujore dhe vjetore të Drejtorisë. Si dhe raporte të tjera të ndryshme si për mbarëvajtjen e Projekteve me rëndësi, raporte të Komisioneve të ndryshme për punë të caktuara, etj. Si dhe raporte të ndryshme për nivelin qëndror.

#### 4. Përmbyllje

Viti 2019 për DUP ka qenë një vit mjaft sfidues në realizimin e objektivave të Drejtorisë. Në përgjithësi puna në DUP është kryer mirë edhe përkundër numrit të vogël të stafit. Këtë vit puna më e madhe është përqendruar në kompletimin e draftit të PZhK-së dhe kërkesa për MMPH-në për hapjen e shqyrtimit publik, shqyrtimin e kërkesave të qytetareve e sidomos të kushteve dhe lejeve ndërtimore dhe legalizimit të objekteve, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e Projekteve Kapitale, Hartimin dhe Miratimin e Planit për vendosjen e Objekteve të përkohshme në prona publike etj.

Gjithashtu, ndër prioritetesh është edhe projekti për Sheshin e Qytetit, i cili do të implementohet në rreth tre vitet e ardhshme e ndarë në faza të caktuara, ku faza e parë ka filluar të ndërtohet dhe po mbikëqyret nga zyrtarë të DUP-së.

**Vlen të ceket se:**

- Çdo ditë po rritet transparenca e punës së drejtorisë, kjo dëshmohet edhe nga shtimi i numrit të kërkesave të qytetarëve si dhe takimeve të shumta me palë.
- Në hartimin e dokumenteve të reja të planifikimit urban potencohet si prioritet përmbledhja e të gjitha planeve tjera të aprovuara dhe harmonizimi i tyre në mes veti duke krijuar kështu një tërësi urbane planifikuese.
- Përkundër stafit të kufizuar, angazhimi i secilit zyrtarë ka qenë maksimal në arritjen e objektivave të drejtorisë.

**Sfidë:**

- Mungesa e zyrës së planifikimit në nivel të drejtorisë dhe mungesa e stafit të mjaftueshëm për tu marrë me procesin e planifikimit minimum një udhëheqës dhe dy zyrtar.
- Mungesa e stafit të mjaftueshëm edhe për detyrat, obligimet dhe proceset tjera. Vlen të cekët që njëri zyrtarët ka dalë në pension këtë vit dhe ende nuk zëvendësuar pozita për shkak të ndërrimit të ligjeve.
- Hapësirat e ngushta dhe numri i vogël i zyrave të urbanizimit.
- Zvarritje e procesit të planifikimit për PZHK si pasojë e specifikave të tij si rezultat i ndryshimit të metodës dhe procedurave nga MMPH me dispozita ligjore në fuqi, nga ai paraprak kur është hartuar.
- Mangësi të dhënave në sektor të ndryshme të kërkuar nga formularët e MMPH për hartimin e profilit të Komunës për Dokumentin PZhK.
- Mos përmbyllja e projekteve të PRrH të cilat kanë kaluar procesin e shqyrtimit dhe pengesat nga MMPH për zbatim të katër PRrH të aprovuara nga Asambleja Komunale.
- Fillimi i procesit të legalizimit të objekteve, përkundër rritjes së detyrave, stafi mbetet i njejtë

Me përkushtimin që kemi, presim që viti 2020 të jetë dhe më i suksesshëm se ky vit që po e lëjmë pas.

Me respekt,

Drejtor i Drejtorisë:

Sanie KUQI

---